

## STATUTI

### I

#### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR «AS TRANSPORT» Sh.p.k.

Une i nenshkruari Astrit Sulaj , i biri i Sejdin\_t,i dl. 01.08.1970, banues Durres,L.15,Rr.A.Goga kam themeluar Shoqerine « AS TRANSPORT » Sh.p.k. me nje Ortak te Vetem,  
Ne mbeshtetje dhe ne frymen e ligjit n.9901 date 14.04.2008,duke qene brenda afatit ligjor,  
Shoqeria « AS TRANSPORT » Sh.p.k.,pas ndryshimit perkates prane QKR , do te operoje sipas Statutit te poshteshenuar :

#### EMRI-QENDRA-KOHEZGJATJA

##### NENI 1

Eshte themeluar nga Ortaku i Vetem Astrit Sulaj Shoqeria « *AS TRANSPORT* » Sh.p.k.

Te gjitha shkresat , apo formularet dhe cdo dokument tjeter korrespondence, nxjerre nga shoqeria qofshin keto me leter ose ne menyre elektronike duhet te permbajne :Numrin unik te identifikimit,formen ligjore te shoqerise,vendndodhjen e regjistruar te shoqerise ,te dhenat nese shoqeria eshte ne likuidim.

##### NENI 2

Shoqeria e ka qendren Lagja 15 Rruga Severin Luzha, Objekt me Nr.Pasurie 89/64, Zonë Kadastrale 8517 Durres, por me Vendim te Ortakut te Vetem Shoqeria munt te krijoje qendra dytesore, filiale, sukursale, agjensi si ne Republiken e Shqiperise ashtu edhe jasht saj.Po me Vendim te Ortakut te Vetem ato mund te suprimohen.

Gjithashtu Shoqeria mund te hapi dyqane dhe pika te tjera tregtimi me

shumice dhe pakice ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jasht saj,

##### NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat

## OBJEKTI I SHOQERISE

### NENI 4

#### Objekti I Shoqerise eshte"

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne fushat e :

-Transport kombetar dhe nderkombetar per mallra dhe pasagjere per te trete e me qira me mjetet e veta ose te te treteve me komunikacion tokesor dhe detar.

-Import eksport,tregti me shumice dhe pakice te materialeve e konstruksioneve metalike,materialeve te ndertimit dhe dyerve te blinduara.

-Dhenie me qera.Celje dhe ushtrimin e aktivitetit te agjensive imobilare, turistike, detare, spedicionere , etj.

-Tregtim te artikujve industriale,ushqimore si edhe tregtimin e tyre me shumice e jashte territorit te vendit.

-Prodhim e tregtim me pakice e shumice te artikujve tekstile te prodhuar ne linjat e saj ose te marre nga te trete.Import dhe tregtim te makinave,pjese kembimi,goma,pajisje elektroshtepiake,hidrosanitare etj

## KAPITALI I SHOQERISE

### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise, ne castin e regjistrimit te saj, eshte 10.000 lek, i perbere nga 1 kuote dhe eshte i vendosur i gjithi nga Ortaku i Vetem Themelues.

Kalimi i kuotave do te behet ne perputhje me kerkesat e nenit 73 dhe 74 te ligjit 9901 date 14.04.2008

## RREGJIMI JURIDIK

### NENI 6

Shoqeria eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe i nenshtrohet Aktit te Themelimit, ketij Statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## ADMINISTRIMI

### NENI 7

Te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe parashikohen ne nenin 81 dhe 95 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per Asamblene e Pergjithshme dhe Administratoret ushtrohen nga Ortaku i

Vetem , i cili do te jete dhe Administratori i Shoqerise per nje periudhe 5 vjet me te drejte riprteritje, Z.Astrit Sulaj

Nder te tjera Administratori perfaqeson shoqerine para te gjitha organeve shteterore dhe gjyqesore,para personave juridike dhe fizike. Ai vendos per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise,per miratimin e pasqyrave financiare,etj.

Administratori mund i atribuojte me prokure fakultetet e veta personave te tjere,por gjithmone qe ata te veprojne brenda tagrave qe jane fiksuar ne prokure.

Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme

#### BILANCI DHE FITIMET

##### Neni 8

Ushtrimi i veprimtarise se shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te te cdo ushtrimi te veprimtarise hartohet bilanci mbi bazen e gjendjes pasurore, te llogarive ekonomike te shoqeruara me nje relacion qe eshte pjese perberese e bilancit..

##### Neni 9

Fitimi neto, pasi eshte hequr rezerva ligjore prej 5% , rezerven I do te kaloje ne favor te Ortakut te Vetem Themelues Z. Astrit Sulaj.

#### MARREDHENIET E PUNE

##### NENI 10

Shoqeria per te zhvilluar aktivitetin e saj munt te punesoje vartesa shqiptare ashtu edhe te huaj.Marredheniet e punes do te rregullohen sipas legjislacionit shqiptar te punes ne fuqi duke lidhur me te punesuarit kontrata kolektive dhe individuale.

Shoqeria detyrohet te respektojte te gjitha dispozitat ligjore perfshire ketu edhe kontributin per sigurimet shoqerore te punonjesve.

Punonjesit jane te detyruar te pranojne dhe respektojne statutin e shoqerise dhe jane pergjegjes para shoqerise per demet qe I shkaktojne asaj.

PRISHJA E SHOQERISE

NENI 11

Kjo shoqeri mund te priset per shkaqet e parashikuara nga neni 99 i ligjit 9901 date 14.04.2008.

Administrastori regjistron prishjen eshoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te ligjit n.9723 date 3.5.2007 « Per Qendren Kombetare te REGjistrimit ».

MOSMARREVESHJET

NENI 12

Mosmarreveshjet qe munt te lindin ndermjet Administratorit dhe vartesave , si dhe ndermjet tij e likuidatoreve, nga zbatimi i ketij Statuti dhe vendimeve te marra rregullisht, ne se nuk zgjidhen ne rrugen e bisedimeve, at'here do te zgjidhen ne rruge gjyqesore.

Neni13

Persa nuk eshte parashikuar ne kete statut do ti referohet legjislacionit ne fuqi te RepublikesseShqiperise.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Astrit Sulaj



Date 16.03.2021